



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 388/1 Prot.

Tiranë, më 27 . 02 . 2025

V E N D I M

Nr. 41, Datë 27 . 02 . 2025

Bazuar në nenin 32, pika 1, shkronja c) dhe pika 2, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me Urdhrin nr. 188, datë 02.12.2024, ka filluar ndjekjen kryesisht të çështjes së mungesës së ofrimit të shërbimeve thelbësore të personave të moshuar që jetojnë vetëm¹.

Në vijim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve të çështjes në shqyrtim

Duke marrë indicien nga transmetimi i emisionit “Inside Story”, më datë 20.11.2024, në kanalin televiziv kombëtar Top Channel², me tematikë: “Skemat e mjerimit”- “Paratë e projekteve sociale shpërdorohen në investime korruptive”, lidhur me mungesën e ofrimit të shërbimeve thelbësore të personave të moshuar që jetojnë vetëm, nisur nga paraqitja e situatës tejet të rëndë dhe kushteve të papërshtatshme të jetesës së znj. M. E. P, një e moshuar 85 vjeçare, e cila jeton e vetme në banesën e shkatërruar nga tërmeti i vitit 2019³; si dhe mbështetur në nenin 41/2/a⁴ të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar, si dhe në nenin 32, pika 1, shkronjat c), dhe pika 2, të

¹ Referuar specifikisht rastit të Znj. M. E. P, me moshë 85 vjeç, e cila jeton e vetme në banesën e saj në qytetin e Durrësit, pasi nuk ka asnjë të afërm që përkujdeset për të.

² <https://youtu.bxxxxxxxxx>

³ Nisur nga paraqitja e situatës tejet të rëndë dhe kushteve të papërshtatshme të jetesës së znj. M. E. P, prezantuar në emisionin “Inside Story”, në Tv Top Channel, me tematikë: “Skemat e mjerimit”- “Paratë e projekteve sociale shpërdorohen në investime korruptive”.

⁴ “Fillimi i procedurës kryesisht është në diskrecionin e organit publik. Organi publik është i detyruar të fillojë procedurën administrative kryesisht kur:

a) ligji ose akti nënligjor parashikon fillimin e procedurës...”

ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar; me Urdhrin nr. 188, datë 02.12.2024, ka filluar ndjekjen kryesisht të çështjes së mungesës së ofrimit të shërbimeve thelbësore të personave të moshuar që jetojnë vetëm.

Referuar informacionit të përcjellë në emisionin sipërcituar, ndër të tjera, evidentohen një sërë problematikash, si:

- Znj. M. E. P, është një e moshuar me moshë 85 vjeç, e cila jeton e vetme pasi nuk ka asnjë të afërm që përkujdeset për të;
- Znj. P jeton në katin e parë të një pallati në lagjen nr. 18, tek pallatet e ish të përndjekurve politikë, Durrës;
- Nga pamjet e transmetuara në kronikën në fjalë, konstatohet se banesa e saj është në kushte të pabanueshme dhe jashtë çdo standardi të një jetese të përshtatshme dhe dinjitoze për një njeri dhe aq më tepër për një të moshuar 85-vjeçare, e cila jeton e vetme, pa përkujdesjen e asnjë personi, familjar, të afërm apo jo;
- Nga kronika evidentohet se pallati është prekur nga dëmtimet e tërmetit të ndodhur në vitin 2019, dhe se të gjitha banesat e tjera janë riparuar nga strukturat përgjegjëse që janë marrë me rindërtimin e banesave të dëmtuara nga tërmeti i vitit 2019, dhe se, vetëm në banesën e znj. P nuk është ndërhyrë për rindërtimin a riparimin e saj. Nga pamjet, banesa duket e dëmtuar, pa dyer dhe dritare dhe në kushte aspak të përshtatshme për jetesë;
- Në banesë mungon furnizimi me energji elektrike dhe ujë të pijshëm.
- E moshuara, znj. P, në intervistën e saj thekson faktin se është e vetme, familjarët e saj kanë vdekur të gjithë dhe se jeton në kushte të mjerueshme, pa ushqim të mjaftueshëm, pa përkujdesje mjekësore, pa ndriçim e ngrohje dhe se në temperaturat e ulëta të dimrit e ka tejet të vështirë jetesën. Po ashtu nuk ka furnizim me ujë të pijshëm, çka e vështirëson akoma dhe më shumë jetesën e saj, larg çdo standardi të jetesës normale e dinjitoze për një të moshuar.

Bazuar në nenin 32/1/c/, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

II. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, LMD-së, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 1613/1, datë 04.12.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion lidhur me problematikën në shqyrtim nga institucionet respektive: Bashkia Durrës, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror (DR SHSSH)

Durrës, Drejtoria Rajonale e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sha (DR OSSH) Durrës dhe Drejtoria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime sha (UK) Durrës, si më poshtë citohet:

“

- *Informacion dhe parashtrimet tuaja në lidhje me situatën sa më sipër, sipas fushës tuaj të përgjegjësisë dhe kompetencave respektive institucionale.*
- *Informacion dhe dokumentacion provues, ku të evidentohet se cilat janë masat e ndërmarra lidhur me secilën problematikë të evidentuar më sipër.*
- *A i është nënshtruar vlerësimit të dëmit të shkaktuar nga tërmeti i vitit 2019, pallati ku jeton e moshuara M. P? Kopje të aktit të konstatimit nga organi përgjegjës, të dëmeve dhe masave apo nevojave për ndërhyrje, riparime të tij, etj, si dhe kopje të akteve të marrjes në dorëzim, nëse janë bërë ndërhyrjet apo riparimet përkatëse.*
- *A i është nënshtruar vlerësimit të dëmit të shkaktuar nga tërmeti i vitit 2019, banesa ku jeton e moshuara M. P, (ndodhur në katin e parë, të pallatit të ish-të përndjekurve politikë, në lagjen nr. 18, Durrës)? Kopje të aktit të konstatimit nga organi përgjegjës, të dëmeve dhe masave apo nevojave për ndërhyrje, riparime të tij, etj, si dhe të akteve të marrjes në dorëzim, nëse janë bërë ndërhyrjet apo riparimet përkatëse.*
- *A është identifikuar si person në nevojë, e moshuara M. P, si person që jeton e vetme pa përkujdesjen e familjarëve apo të afërme? A është ndihmuar apo asistuar nga strukturat përkatëse të Bashkisë Durrës apo DR SHSSH Durrës? Kopje të akteve provuese apo fakte e rrethana shpjeguese. Nëse po, si është ndihmuar, asistuar konkretisht znj. P, referuar secilës problematikë të evidentuar, nga strukturat tuaja përkatëse.*
- *Nëse dispononi informacion, prej sa vitesh e moshuara M. P është banore në lagjen nr. 18, tek pallatet e ish të përndjekurve politikë, Durrës?*
- *A është furnizuar ndër vite me energji elektrike dhe ujë të pijshëm banesa në të cilën jeton znj. M. E. P? Aktualisht, a vijon të furnizohet banesa e saj me energji elektrike apo me ujë të pijshëm. Argumentimin tuaj.*
- *Nëse jo, me marrjen dijeni të këtij fakti, nisur nga specifika dhe ndjeshmëria e rastit të znj. M. P, konkretisht cilat janë masat që janë ndërmarrë apo do të ndërmerren nga ana juaj respektivisht për furnizimin e banesës së saj me energji elektrike dhe ujë të pijshëm? Parashtrime dhe kopje të akteve shkresore.*
- *Sa është numri i personave të moshuar që jetojnë të vetëm, pa përkujdesjen e familjarëve apo të afërmeve, në Bashkinë Durrës? Cilat janë masat apo veprimet e ndërmarra nga ana juaj rast pas rasti. A ka një plan veprimi apo masash për këtë kategori personash vulnerabël, nga ana e institucioneve tuaja respektive? Nëse po, një kopje të akteve shkresore.*
- *Si dhe çdo informacion ose dokumentacion tjetër që mendoni se i shërben sqarimit të çështjes.”*

Në këtë shkresë Komisioneri ka theksuar gjithashtu se: “Nisur nga ndjeshmëria e rastit të znj. P dhe situata tejet kritike në të cilën ajo ndodhet, në kushtet e një mjerimi të skajshëm, ku diskutohet mbijetesa në temperaturat e ulëta të dimrit, Komisioneri kërkon marrjen e masave urgjente për largimin e përkohshëm të zonjës së moshuar M. P, në një qendër të përkujdesjes për të moshuarit

në qytetin e Durrësit, ku ajo banon, deri në marrjen e masave për rregullimin e banesës së saj me kushtet e paramentrat e një banese normale, të përshtatshme për një jetesë dinjitoze dhe në përputhje me standardet e kërkuara.”

Në vijim të sa më sipër kërkuar, Komisioneri ka administruar informacionin e dërguar:

- Njëpërmjet shkresës me nr. 13042/2 prot., datë 23.12.2024, të OSSH sha;
- Njëpërmjet shkresës me nr. 3822 prot., datë 24.12.2024, të DR SHSSH Durrës;
- Njëpërmjet shkresës me nr. 5893/1 prot., datë 26.12.2024, të UK Durrës.

Ndërsa, Bashkia Durrës, megjithëse ka marrë dijeni për shkresën nr. 1613/1, datë 04.12.2024, të Komisionerit, më datë 05.12.2024, fakt ky që rezulton i provuar nga lajmërim marrja e shërbimit postar: RR 721 702 895 AA, administruar në dosje, nuk ka kthyer përgjigje.

- Në vijim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën nr. 209, datë 29.01.2025, iu drejtua sërish Bashkisë Durrës, me një kërkesë të përsëritur për informacion dhe dokumentacion në lidhje me çështjen.

Në shkresën e sipërpërmendur, Komisioneri i bën kujtesë subjektit, për të dërguar informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar brenda 5 (pesë) ditëve pune, nga marrja dijeni e shkresës, duke i sjellë në vëmendjen se mosplotësimi i kësaj kërkesë, përbën shkelje të dispozitave të LMD-së.

Bashkia Durrës ka marrë dijeni për shkresën nr. 209 prot., datë 29.01.2025, të Komisionerit, më datë 30.01.2025, fakt ky që rezulton i provuar nga lajmërim marrja e shërbimit postar: RR 725 096 383 AA, administruar në dosje por sërish nuk ka kthyer përgjigje.

III. Pas kryerjes së hapave të mësipërm proceduralë, Komisioneri çmon se:

Bashkia Durrës, si subjekt kundër të cilës është iniciuar hetimi kryesisht i Komisionerit, lidhur me problematikën në fjalë, me dijeninë e plotë nuk ka mbështetur Komisionerin në ushtrimin e kompetencës së tij ligjore për të shqyrtuar çështjet për diskriminim, të përcaktuar në nenin 32/1/c, të LMD-së duke mos dhënë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në pamundësi të një informacioni të detajuar dhe verifikimit të dokumentacionit të kërkuar, është vënë në situatën e pamundësisë për të arritur në konkluzionin mbi trajtimin e pafavorshëm e të padrejtë të shtetases së moshuar M. E. P, ndodhur në kushtet e një jetese në mjerim të skajshëm.

Duke mos dhënë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar Bashkia Durrës nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 32/2, të LMD-së, sipas të cilit: “2. Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”. Ky mosveprim, kjo mospërmbushje e këtij detyrimi ligjor, në bazë të nenit 33/13, të LMD-së shoqërohet me marrjen e masës administrative, gjobë.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi arrin në konkluzionin se, Bashkia Durrës, është në shkelje të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 32/2, të LMD-së, shkelje e cila sipas nenit 33/13, të po këtij ligji, është e dënueshme me gjobë⁵.

Për personat juridik, siç është në rastin konkret është Bashkia Durrës, neni 33, pika 13, të LMD-së, përcakton shkrehimisht: *“Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë”*:..... *b) personi juridik nga 60.000 deri në 600.000 lekë;.....”*.

Në lidhje me masën e gjobës, Komisioneri mban në konsideratë parashikimet dhe kriteret e vendosura në nenin 33, pika 12, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku sanksionohet se: *“12. Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës. Nëse vendoset gjobë, Komisioneri përcakton shumën e gjobës duke marrë parasysh: i) natyrën dhe fushën e veprimit të shkeljes dhe ndikimin mbi viktimën; dhe ii) rrethanat personale e financiare të shkelësit, veçanërisht duke marrë në konsideratë të gjitha burimet e të ardhurave dhe nëse shkelja kryhet nga një person juridik privat, merren parasysh aktivet e bilancit dhe fitimi, si dhe pagat totale të paguara punonjësve; c) nëse e njëjta shkelje diskriminon disa persona, vendoset vetëm një gjobë, por duke marrë parasysh kërkesat e shkronjës “b” të këtij neni.”*

Duke mbajtur në konsideratë kriteret e mësipërme për përcaktimin e masës së gjobës, duke u bazuar në, natyrën dhe ndikimin që ka shkelja e konstatuar tek vendimmarrja e Komisionerit, si dhe faktin që, Bashkia Durrës, nuk është përsëritëse në konsumimin e shkeljeve të së njëjtë natyrë; Komisioneri, arrin në përfundimin se, Bashkia Durrës, duhet të gjobitet me 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për mosdhënien e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 1, 2, 3/1, nenin 7/1, nenin 21/1, nenin 32/1, shkronja c), e pika 2, nenin 33/1 si dhe nenin 33/13, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Bashkia Durrës, të gjobitet në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për mosdhënien e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

⁵ Për analogji të rastit citojmë vendimet me gjobë të KMD-së: nr. 96, datë 12.04.2024; nr. 135, datë 13.05.2024; nr. 140, datë 16.05.2024.

2. Gjoha të paguhet në Buxhetin e Shtetit brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga marrja dijeni. Me kalimin e këtij afati, vendimi i dhënë shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit, me kërkesë të Komisionerit.
3. Pagesa e vlerës së gjobës të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 1, Distrikti (TDO), Llogaria ekonomike: 7115499.
4. Dërgimi i informacionit të kërkuar nga Komisioneri, brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijeni e Vendimit për sanksionin me gjobë, sjell shfuqizimin e tij.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA